



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO
Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-iks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

Field Code Changed

RREGULLORE

Formatted: Albanian

PËR MIRËNJOHJET, SHPËRBLIMET DHE LAUREATËT MË TË MIRË TË VITIT

Formatted: Albanian

202~~52~~

Në bazë të nenit 15 paragrafi 2.1 si dhe nenit 43 paragrafi 2 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së badmintonit në mbledhjen e vetë të mbajtur në Shtëpinë e Sporteve në Prishtinë të datës ~~05.11.2022~~ 26.03.2025 nxjerr:

RREGULLORE

PËR MIRËNJOHJET, SHPËRBLIMET DHE LAUREATËT MË TË MIRË TË VITIT

Neni 1

Duke pasur parasysh angazhimin, punën, sukseset si dhe prezentimin e sportit Kosovar në në vend dhe jashta vendit, Federata e Badmintonit të Kosovës parashehë këto mirënjohje dhe dekorata, për sportistët ekipet, nxënësit, punëtorët sportiv, gazetarët sportiv dhe individ tjerë si vijon:

- Mirënjohje
- Falenderime
- Diploma për ekipe
- Diploma për individ
- Plaketa (e artë, e argjente dhe e bronzit)
- Medalje (e artë, e argjente dhe e bronzit)
- Shenja të B.F.K (e artë, e argjent dhe e bronzit)
- Flamuj përkujtimor
- Kupa
- Dhurata dhe rekuizita sportive
- Dhurat speciale për masivitet, cilësi dhe fer - plej
- Dhuratë speciale, përcjellja e ndonjë manifestimi apo ngjarje me rëndësi sportive në Kosovë apo jashta sajë.

Neni 2

Ndarja e mirënjohjeve, dekoratave dhe shpërblimeve bëhet në bazë të rezultateve të arritura në garat kombëtare, ballkanike, europiane dhe deri kampionatët botërore.

Neni 3

Vlerësimi i rezultateve të arritura të ekipeve, individëve dhe të tjerëve bëhet sipas kretereve të përcaktuara në tabelën e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Kriteret dhe elementet për disa kategori janë të përshkruara dhe janë bashkangjitur tabelës dhe kësaj Rregullore.

Neni 4

Kriteret dhe elementet për disa kategori të tjera, si zgjedhja e punëtorit më të mirë sportive, gjyqtarit më të mirë, gazetarit më produktiv etj. Janë të përcaktuar në tekstin i cili i bashkangjitet tabelës.

Për këto kategori vlejné edhe këto elemente:

- masiviteti, cilësia, organizimi, numri i ekipeve, numri i garave të organizuara, pjesëmarrja në gara në vend dhe jashta sajë, rezultatet etj.

- tek individët, si gjyqtari, punëtori sportive etj për bazë merren realizimi sistematik i detyrave të parashtruara, nga numri i aktiviteteve të realizuara dhe duke ju falenderuar punës së tyre në organizimin cilësor të detyrave të tyre, dhe një bashkëpunimi korrekt mes lojtarëve dhe bashkëpunorëve, të cilët kanë ndikuar në përparimin dhe avansimin e Badmintonit në Kosovës dhe jashtë sajë, si në rrafshin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Neni 5

Për vitin ~~2019~~2025-2026 janë të parapara që të dhurohen këto shperblime dhe dhurata për garat e të tri niveleve

Neni 6.

Për garat e kampionatit individula të Kosovës (shtetëror), B.F.K-ja mund të ndajë:

- Medalje, mirënjohje për vendin e parë dhe kupë
- Medalje, mirënjohje për vendin e dytë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë

Neni 7.

Për garat e kampionatit pët qift, B.F.K-ja mund të ndajë:

- Medalje, mirënjohje për vendin e parë dhe kupë
- Medalje, mirënjohje për vendin e dytë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë

Neni 8.

Për garat e kampionatit pët miks, B.F.K-ja mund të ndajë:

- Medalje, mirënjohje për vendin e parë, kupë
- Medalje, mirënjohje për vendin e dytë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë
- Medalje, mirënjohje për vendin e tretë

Neni 9.

Për klubet, Shoqatat e gjyqtarëve, trajnerëve etj B.F.K-ja ndanë:

- mirënjohje
- shpërblime të posaqme

Neni 10.

Në raste specifike Komisioni mund t'u ndajë shpërblime të gjithë pjesëmarrësve, në ndonji manifestim me karakter kombëtar (shtetëror) festiv, me ndarje të:

- diplomave
- shenjave të B.F.K
- suvenireve të ndryshme si kujtim për ato ngjarje sportive

Neni 11.

Federata e Badmintonit e Kosovës i propozon, klubeve komunale, Shoqatës së trajnerëve dhe asaj të gjyqtarëve, klubeve etj. Që sipas mundësisë të ndajnë mirënjohje ose shpërblime në fushën e veprimtarisë dhe aktivitetit të tyre të cilin e organizojn.

Neni 12.

Më qëllim të stimulimit të organizatoreve të garave, punës që e bëjnë, duke pasur parasysh rangun e garave apo të turneve që organizon Federata e Badmintonit, Komisioni mund të ju ndajë:

- Mirënjohje
- plaketa speciale
- shpërblime tjera

Neni 13.

Komisioni, në fund të çdo viti, për shpalljen e më të mirëve kërkon nga klubet e saja propozimet e më të mirëve, dhe në bazë të kriterëve të përcaktuar me këtë Rregullore, bënë propozimin e listës dhe të njëjtën ja paraqetë Bordit Ekzekutiv të B.F.K. në miratim.

Neni 14.

Komisioni i B.F.K-së bënë shpalljen e më të mirëve të vitit si vijon:

- sportistja e vitit për grup moshat	11 vjeq-vajzat
- sportisti i vitit per grup moshat	11 vjeq-djem
- sportistja e vitit për grup moshat	13 vjeq-vajzat
- sportisti i vitit për grup moshat	13 vjeq-djemt
- sportistja e vitit për grup moshat	15 vjeq-vajzat
- sportisti i vitit per grup moshat	15 vjeq-djemt
- sportistja e vitit për grup moshat	17 vjeq-vajzat
- sportisti i vitit për grup moshat	17 vjeq-djemt
- sportistja e vitit për grup moshat	19 vjeq-vajzat
- sportisti i vitit për grup moshat	19 vjeq-djemt
- sportisti i vitit për senior	senior
- sportisti i vitit për seniore	seniore

- sportistja e vitit për grup moshat e veteranëve-vajzat
- sportisti i vitit për grup moshat veteranëve-djemt
- trajneri më i sukseshëm
- qifti i gjyqtarëve më të sukseshëm sipas notimit nga Gjyqtari i garave
- gazetari më i frytshëm gjatë vitit.
- punëtori më i dalluar sportive
- klubi më i mire në konkurrencën e meshkujëve
- klubi më i mirë në konkurrencën e femrave

Neni 15.

B.F.K-ja mund ti ndaj mirënjohje dhe falenderime edhe asociacioneve jo sportive, të cilat kanë kontribuar dhe kontribojnë në zhvillimin e Badmintonit në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.

Neni 16.

Kriteret e përcaktuar në këtë Rregullore, janë obligative për të gjitha klubet ekzistuese.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË LËMINË E SPORTEVE TË CEKURA MË LARTË MUNDË TË JENË:

Neni 17.

Për listën e më të mirëve mund të kandidohen:

1. Sportist nga klubet të cilat janë anëtarë të Federatës së Badmintonit të Kosovës, dhe të cilët kanë zhvilluar aktivitet gjat vitit kalendarik në Kosovë.
2. Individët të inkuadruar në sport të badmintonit punëtor profesional:
 - trajner
 - gjyqtarë
 - punëtor sportive
3. Klubet
4. Organizatat dhe institucionet tjera të cilat në një apo tjetër mënyrë kanë ndikuar në zhvillimin e sportit të Badmintonit.

Neni 18.

Propozimet për pozicionet 1.2.3.4 duhet të bëhen ekskluzivisht përmes klubit, apo ndonji asocionit tjetër të B.F.K.

Neni 19.

Kusht, për t'u shpalljen e sportistit dhe sportistëve më të mirë të vitit paraqesin:

1. Rezultatet e arritura në gara:
 - Garat Botërore
 - Garat Europiana
 - Garat Ballkanike
 - Garat e Kombëtare
 - Garat e Kosovës

Neni 20.

Pranë kriterëve standarde, për vlerësimin e cilësisë dhe përcaktimin për klubin, lidhjen komunale, duhet të merren parasysh edhe këto komponente me parametra specifike:

1. Niveli i garave
2. Sistemi i garave
3. Konkurenca - masiviteti i garave

Neni 21.

Trajner më të sukseshëm komisioni për shpalljen e sportistëve, shpall atë trajner i cili gjatë një viti kalendarik, ka pasur më së shumti suksese në bazë të rezultateve, si dhe në atë më punën më gjeneratë e reja Pastaj niveli i garimit, masiviteti etj.

Trajneri duhet të jetë aktivë gjatë tërë vitit për t'u shpallur si më i suksesshmi.

Neni 22.

Komisioni për shpalljen e sportistëve më të mire të vitit, në lëminë e ndarjes së drejtësisë e shpall qiftin e gjyqtarëve më të suksesshëm të B.F.K, në bazë të propozimit të Komisarit-së, e cila duhet të bëjë këtë në bazë të notimit të ndeshjeve të drejtura nga qiftët në fjalë.

Si gjyqtar më të të suksesshëm shpallën ekskluzivisht vetëm qifti i gjyqtarëve, e jo gjyqtarët si individ.

Neni 23.

Punëtor sportive, komisioni shpall atë individ i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen, zhvillimin dhe masivitetin e Badmintonit, mbrenda një viti, çka është vështirë të përcaktohet komisioni vetëm për një vit kalendarik, por duhet të merret në shqyrtim një periudhë më e gjatë kohore.

Neni 24.

Shpallja e sportistëve më të mire dhe klubeve bëhet në bazë të tabelës e cila disponon me të gjitha kriteret, në formë tabelare, ku janë të përfshira të gjitha aktivitetet e mundëshme të sportistëve tanë gjatë një viti si vijon:

	EKIPET			TRAJNERI			SPORTISTI			totali
NIVELI I GARAVE	I	II	III	I	II	III	I	II	III	
Kampionati botëror	100	90	80	100	90	80	100	90	80	
Kampionati European	50	40	30	50	40	30	50	40	30	
Kampionati ballkanik	40	30	20	40	30	20	40	30	20	
Kampionati Kombëtare	20	15	10	25	15	10	25	15	10	
Kampionati i Kosovës	15	10	5	15	10	5	15	10	5	
Turnire të ndryshme	10	8	5	10	8	5	10	8	5	

Neni 25.

Këtë Rregullore e aprovon Kuvendi i BFK-së pas propozimit nga Bordi Ekzekutiv kurse ndërrimet dhe plotësimet i propozon Komisioni për shpërblime dhe dekorata të cilat i miraton Bordi Ekzekutiv.

Neni 26.

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i BFK-së

Prishtinë,

Përfaqësues i autorizuar i BFK-së



~~05.11.2022~~

~~26.03.2025~~

Lulzim Haziri (Kryetar)